



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 1516/1 Prot

Tiranë, më 15.10.2019

**V E N D I M**

Nr.93, datë 15.10.2019

*“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Lezhë në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit”.*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Lezhë,

**VËREJ SE,**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65 (nr. 1453 prot), datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht

procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Lezhë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Këshilli i Bashkisë Lezhë, me vendimin nr. 7, datë 28.1.2019, “Për miratimin e buxhetit për vitin 2019 dhe të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Lezhë dhe njësisve administrative e institucioneve në varësi të saj. Në zbatim të këtij vendimi, kryetari i Bashkisë Lezhë, bazuar në nenin 64, shkronja “j”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ka nxjerrë vendimin nr. 106, datë 9.4.2019, “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasave për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë, të njësisve administrative, institucioneve vartëse dhe të punonjësve të njësisve të shërbimeve për vitin 2019”. Kjo strukturë dhe organikë është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Lezhë së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **209** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **10** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **25** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **174** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **43** pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **143** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë se aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe josipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues; ndërsa **23** pozicione të shërbimit civil rezultuan vende vakant.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. \*\*\*\*\* , Specialist në Sektorin e Aseteve, akt nr. 34, datë 16.1.2018.
2. \*\*\*\*\* , Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave, akt nr.14, datë 13.1.2017.

3. \*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, akt nr. 130 datë 30.5.2016.
4. \*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Aseteve, akt nr. 112, datë 5.4.2019.
5. \*\*\*\*\*, Specialiste në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave, akt nr. 74, datë 1.3.2017.
6. \*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Auditit, akt nr. 48, datë 16.2.2017.
7. \*\*\*\*\*, Specialiste Kontabiliteti, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, akt nr.210, datë 23.5.2018.
8. \*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Kontabilitetit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, akt nr. 358, datë 25.6.2018.
9. \*\*\*\*\*, Specialiste Pagash, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, akt nr.491, datë 2.8.2018.
10. \*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Kontabilitetit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, akt nr. 82, datë 1.3.2017.
11. \*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Kontabilitetit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, akt nr. 671, datë 14.12.2018.
12. \*\*\*\*\*, Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, akt nr. 93, datë 4.5.2016.
13. \*\*\*\*\*, Specialiste e Hartimit të Buxhetit, Drejtoria Financës dhe Buxhetit, akt nr. 98 datë 25.3.2019.
14. \*\*\*\*\*, Përgjegjëse e Sektorit të Kontabilitetit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, akt nr.670 date 14.12.2018.
15. \*\*\*\*\*, Specialiste Pagash në Sektorin e Buxheit dhe Pagave, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, akt nr. 99, datë 25.03.2019.
16. \*\*\*\*\*, Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Kontabilitetit, akt nr.480, datë 1.8.2018.

17. \*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Terrenit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, akt nr. 270, datë 3.8.2017.
18. \*\*\*\*\*, Specialist në Agjensinë e Mbledhjes së Taksave, (Sektori i Terrenit), Drejtoria e të Ardhurave Vendore, akt nr. 90, datë 4.5.2016.
19. \*\*\*\*\*, Përgjegjëse e Sektori të Borxhit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, akt nr. 304 date 18.06.2018
20. \*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Rregjistrimit, Vlerësimit dhe Kontabilitetit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, akt nr.53, datë 31.3.2016.
21. \*\*\*\*\*, Specialist i Evidentimit dhe Mbledhjes së Borxhit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, akt nr. 229, datë 29.5.2019.
22. \*\*\*\*\*, Specialiste në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, akt nr. 300, datë 7.7.2016
23. \*\*\*\*\*, Specialist i Taksave Vendore, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, akt nr. 553, datë 28.09.2018.
24. \*\*\*\*\*, Specialist Jurist, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, akt nr. 81, datë 29.4.2016.
25. \*\*\*\*\*, Specialist për Mbledhjen e Taksave (Sektori i Terrenit), Drejtoria e të Ardhurave Vendore, akt nr. 100, datë 4.5.2016.
26. \*\*\*\*\*, Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore Familjare, Drejtoria të Ardhurave Vendore, akt nr. 75, datë 18.3.2019.
27. \*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Projekteve Strategjike, Integritit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtoria e Programim Zhvillimit, akt nr. 258, datë 12.6.2019.
28. \*\*\*\*\*, Specialist i Marrëdhënieve me Jashtë, Sektori i Projekteve Strategjike, Integritit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtoria e Programim Zhvillimit, akt nr. 48, datë 1.2.2019.
29. \*\*\*\*\*, Specialiste e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Programim Zhvillimit dhe Integritit European, akt nr. 154, datë 30.4.2018.

30. \*\*\*\*\*, Specialiste e Statistikës dhe Analizës, në Drejtorinë e Integritit dhe Projekteve të Zhvillimit, akt nr. 88 datë 4.5.2016.
31. \*\*\*\*\*, Përgjegjës i Sektorit të Projekteve Strategjike, Integritit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtoria e Programim Zhvillimit, akt nr.257, datë 12.6.2019.
32. \*\*\*\*\*, Përgjegjëse Sektori (Specialiste e Integritit), Drejtoria e Integritit European dhe Strategjive të Zhvillimit, akt nr. 91, datë 24.5.2016.
33. \*\*\*\*\*, Drejtor i Programim Zhvillimit dhe Qeverisjes Elektronike, akt nr. 4, datë 31.8.2015.
34. \*\*\*\*\*, Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, akt nr. 83, datë 19.2.2018.
35. \*\*\*\*\*, Përgjegjëse e Sektorit të Studimit, Lejeve Zhvillimore dhe Statistikës, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, akt nr. 65, datë 13.2.2019.
36. \*\*\*\*\*, Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Projekteve dhe Monitorimit të Investimeve, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, akt nr. 487, datë 1.8.2018.
37. \*\*\*\*\*, Specialist jurist, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, akt nr. 52, datë 16.2.2017.
38. \*\*\*\*\*, Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, akt nr. 301, datë 7.7.2016.
39. \*\*\*\*\*, Specialist në Hartimin e Projekteve dhe Monitorimit të Investimeve, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, akt nr. 207, datë 21.11.2018.
40. \*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, akt nr. 475, datë 31.7.2018.
41. \*\*\*\*\*, Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Kontratë Pune lidhur nëdatën 1.3.2019.
42. \*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Lejeve Zhvillimore dhe Statistikës, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, akt nr. 208, datë 21.11.2018.

43. \*\*\*\*\*, Specialiste e Transportit dhe Infrastrukturës (ZIN), Drejtoria e Shërbimeve, Transportit dhe Infrastrukturës, akt nr. 387, datë 29.6.2018.
44. \*\*\*\*\*, Specialiste e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Lejeve të Transportit, akt nr. 576, datë 1.11.2016.
45. \*\*\*\*\*, Specialiste (ekonomiste), Drejtoria e Shërbimeve Publike, akt nr.25, datë 21.1.2019.
46. \*\*\*\*\*, Specialist (inxhinier mekanik), Drejtoria e Shërbimeve, Transportit dhe Infrastrukturës, akt nr. 390, datë 29.6.2018.
47. \*\*\*\*\*, Specialiste Ekonomiste dhe Buxheti, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Transportit dhe Infrastrukturës, akt nr. 386 datë 29.6.2018.
48. \*\*\*\*\*, Specialist (supervizor) i Sipërmarrjeve, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Transportit dhe Infrastrukturës, akt nr. 532, datë 1.11.2016.
49. \*\*\*\*\*, Specialist jurist, Drejtoria e Shërbimeve Publike, akt nr. 138, datë 31.5.2016.
50. \*\*\*\*\*, Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile dhe Menaxhimit të Krizave, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, akt nr. 630, datë 21.11.2018.
51. \*\*\*\*\*, Specialiste e Monitorimit dhe Koordinimit të Emergjencave, Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Menaxhimit të Krizave, akt nr. 94, datë 4.5.2016.
52. \*\*\*\*\*, Specialist i Monitorimit në Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Menaxhimit të Krizave, akt nr. 456, datë 30.9.2016.
53. \*\*\*\*\*, Specialist në Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Menaxhimit të Krizave, akt nr. 627, datë 20.12.2016.
54. \*\*\*\*\*, Specialist në Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Menaxhimit të Krizave, Kontratë Pune nr. 10609 prot., datë 4.12.2017.
55. \*\*\*\*\*, Specialist i Emergjencave Civile, në Sektorin e Emergjencave Civile Drejtoria e Shërbimeve Publike, akt nr. 22, datë 28.1.2019.

56. \*\*\*\*\*, Specialist i Emergjencave Civile, në Sektorin e Emergjencave Civile, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, akt nr.213, datë 23.5.2018.
57. \*\*\*\*\*, Specialist Planifikimi në Sektorin e Emergjencave Civile, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, akt nr. 434, datë 3.9.2019.
58. \*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Kontratë Pune, lidhur në datën31.7.2017.
59. \*\*\*\*\*, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, akt nr. 224, datë 23.5.2018.
60. \*\*\*\*\*, Specialiste, Sekretari i Protokoll, WEB, Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujitjes, akt nr. 427 date 07.09.2016.
61. \*\*\*\*\*, Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit, Kontrollit Veterinar dhe Ushqimor, Drejtoria e Bujqësisë, akt nr. 459, datë 24.7.2018.
62. \*\*\*\*\*, Specialist Veterinar, në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Kontrollit Veterinar, Drejtoria e Bujqësisë dhe Ujitjes, akt nr. 585, datë 3.11.2016.
63. \*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Kontrollit Veterinar dhe Ushqimit, Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujitjes, akt nr. 376, datë 1.8.2016.
64. \*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Kontrollit Veterinar, Drejtoria e Bujqësisë dhe Ujitjes, akt nr. 303, datë 14.6.2018.
65. \*\*\*\*\*, Specialist (Agronom + Arkiv), Sektori i Pranimit të Dokumentave, Drejtoria e Bujqësisë, akt nr. 104, datë 13.4.2018.
66. \*\*\*\*\*, Specialist Topograf, në Sektorin e Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave, Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, akt nr. 70, datë 18.2.2019.
67. \*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave, Drejtoria e Bujqësisë, akt nr. 603, dateë 7.11.2018.

68. \*\*\*\*\*, Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave, Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, akt nr.212, datë 23.5.2018.
69. \*\*\*\*\*, Specialist i Kontrollit Veterinar dhe Ushqimor në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Kontrollit Veterinar dhe Ushqimor, Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, akt nr. 236, datë 29.5.2019.
70. \*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin Veterinar dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujitjes, Kontratë Pune nr. 9610 prot., datë 1.11.2017.
71. \*\*\*\*\*, Specialist i Drejtorisë së Bujqësisë, Kontratë Pune lidhur në datën 1.6.2017.
72. \*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Bujqësisë, akt nr. 376, datë 29.9.2017.
73. \*\*\*\*\*, Specialist në Drejtorinë e Bujqësisë, Kontratë Pune lidhur në datën 30.6.2017.
74. \*\*\*\*\*, Specialiste në Drejtorinë e Bujqësisë, Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Kontrollit Veterinar, Kontratë Punelidhur në datën 8.7.2019.
75. \*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Pranimi dhe Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave (Kadastrës), Drejtoria e Bujqësisë, akt nr. 23, datë 12.1.2018.
76. \*\*\*\*\*, Specialist i Bletarisë dhe Pemëtarisë, Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujitjes, akt nr. 558, datë 28.9.2018.
77. \*\*\*\*\*, Specialiste (Administratore), në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe PAK, Drejtoria e Shërbimit Social, akt nr. 401, datë 3.8.2016.
78. \*\*\*\*\*, Specialiste në Drejtorinë e Shërbimit Social, akt nr. 495, datë 19.12.2017.
79. \*\*\*\*\*, Specialiste në Drejtorinë e Mirëqënies Sociale, Barazisë Gjinore dhe Kujdesit Social, akt nr. 107, datë 11.5.2016.
80. \*\*\*\*\*, Specialiste e Kujdesit Social në Sektorin e Kujdesit Social, Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, akt nr. 16, datë 08.01.2019.



81. \*\*\*\*\*, Specialist në Drejtorinë e Shërbimit Social, akt nr. 550, datë 25.09.2018.
82. \*\*\*\*\*, Specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, akt nr. 27, datë 13.1.2017.
83. \*\*\*\*\*, Inspektore (Kordinator) për Qendrën Ditore, të Moshës së Tretë, Komunitare, Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, akt nr. 152, datë 30.4.2018.
84. \*\*\*\*\*, Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe PAK, Drejtoria e Shërbimit Social, akt nr. 318, datë 22.7.2019.
85. \*\*\*\*\*, Përgjegjëse e Sektorit të Kujdesit Social, Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, akt nr. 236, datë 28.5.2019.
86. \*\*\*\*\*, Specialiste e Turizmit, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr. 18, datë 13.1.2017.
87. \*\*\*\*\*, Specialiste e Turizmit, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kultures, Rinisë dhe Sporteve, akt nr. 474, datë 30.9.2016.
88. \*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Promovimit të Turizmit, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr.389, datë 3.10.2017.
89. \*\*\*\*\*, Specialist i Sektorit i Promovimit të Turizmit, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr.213, datë 30.6.2017.
90. \*\*\*\*\*, Specialist në Drejtorinë e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Kontratë Pune lidhur në datën1.6.2017.
91. \*\*\*\*\*, Specialiste e Turizmit, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr. 106, datë 29.3.2019.
92. \*\*\*\*\*, Përgjegjës i Sektorit të Turizmit, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr. 126, datë 24.5.2016.
93. \*\*\*\*\*, Specialist i Sportit, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr. 97, datë 4.5.2016.

94. \*\*\*\*\*, Specialist i Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr. 461, datë 30.9.2016.
95. \*\*\*\*\*, Specialiste në Drejtorinë e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr. 15, datë 8.1.2019.
96. \*\*\*\*\*, Specialiste Arsimi, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr. 582, datë 3.11.2016.
97. \*\*\*\*\*, Specialiste Arsimi, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr. 125, datë 24.5.2016.
98. \*\*\*\*\*, Përgjegjës Sektori, Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr. 87, datë 13.3.2017.
99. \*\*\*\*\*, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, akt nr. 43, datë 31.3.2016.
100. \*\*\*\*\*, Specialist Arkive, Zyra e Protokoll Arkivës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, akt nr. 645, datë 26.11.2018.
101. \*\*\*\*\*, Specialist Arkive, Zyra e Protokoll Arkivës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, akt nr. 119, datë 23.5.2016.
102. \*\*\*\*\*, Specialiste Protokolli, Zyra e Protokoll Arkivës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Kontratë Pune lidhur në datën 6.2.2019.
103. \*\*\*\*\*, Përgjegjëse e Zyrës së Arkiv- Protokollit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, akt nr. 106, datë 11.5.2016.
104. \*\*\*\*\*, Specialiste (ekonomiste), Drejtoria e Burimeve Njerëzore, akt nr. 669, datë 14.12.2018.
105. \*\*\*\*\*, Specialist IT (*Mirëmbajtjen e Programeve Elektronike*), Drejtoria e Programim Zhvillimit, akt nr. 145, datë 1.6.2016.
106. \*\*\*\*\*, Specialiste Protokolli, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, akt nr. 242, datë 28.5.2018.
107. \*\*\*\*\*, Specialist i Shërbimeve Publike, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr. 158, datë 30.4.2019.

108. \*\*\*\*\*, Specialist Finance - Arkëtare, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr. 524 date 21.11.2016.
109. \*\*\*\*\*, Specialist i Promovimit të Turizmit, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr. 537, datë 1.11.2016.
110. \*\*\*\*\*, Specialist i Promovimit të Turizmit, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr. 199, datë 30.10.2018.
111. \*\*\*\*\*, Specialist i Promovimit të Turizmit, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr. 199, datë 30.10.2018.
112. \*\*\*\*\*, Specialiste Veterinere, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr. 565, datë 1.11.2016
113. \*\*\*\*\*,Specialiste PAK, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr. 394, datë 29.6.2018.
114. \*\*\*\*\*, Specialist PAK dhe Zyrës me Një Ndalesë, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr. 549, datë 1.11.2016.
115. \*\*\*\*\*, Specialist i Taksave Vendore, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr.393, datë 29.6.2018.
116. \*\*\*\*\*, Specialist i Tatim Taksave, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr.560, datë 1.11.2016.
117. \*\*\*\*\*, Specialist Jurist dhenë Zyrën me Një Ndalesë, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr.544, datë 1.11.2016.
118. \*\*\*\*\*, Specialist i Arkivit, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr.536, datë 1.11.2016.
119. \*\*\*\*\*, Specialiste Protokolli, Njësia Administrative Shëngjin, akt nr.535, datë 1.11.2016.
120. \*\*\*\*\*, Specialiste Protokoll Arkivi, Njësia Administrative Shënkoll, akt nr. 341, datë 20.7.2016.

121. \*\*\*\*\*, Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, Njësia Administrative Shënkoll, akt nr. 345, datë 20.7.2016.
122. \*\*\*\*\*, Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Barazisë Gjinore, Njësia Administrative Shënkoll, akt nr.32, datë 13.1.2017.
123. \*\*\*\*\*, Specialiste e Shërbimit Veterinar dhe Kontrollit Ushqimor, Njësia Administrative Shënkoll, akt nr. 350, datë 22.6.2018.
124. \*\*\*\*\*, Specialist i të Ardhurave Vendore, Njësia Administrative Shënkoll, akt nr. 348, datë 20.7.2016.
125. \*\*\*\*\*, Specialist Turizmi, Njësia Administrative Shënkoll, akt nr. 555, datë 29.8.2018.
126. \*\*\*\*\*, Specialiste e Taksave Vendore, Njësia Administrative Zejmen, akt nr. 472, datë 31.7.2018.
127. \*\*\*\*\*, Specialist Protokoll Arkivit dhe Informacionit, Njësia Administrative Zejmen, Kontratë Pune lidhur në datën 10.10.2017.
128. \*\*\*\*\*, Specialiste ne Njësinë Administrative Zejmen, Kontratë Pune lidhur në datën 1.6.2018.
129. \*\*\*\*\*, Specialiste e Bujqësisë, Njësia Administrative Kolsh, akt nr. 556, datë 28.9.2018.
130. \*\*\*\*\*, Specialiste e Ndhmës Ekonomike, PAK dhe Barazisë Gjinore, Njësia Administrative Kolsh, akt nr. 333, datë 7.7.2016.
131. \*\*\*\*\*, Specialiste e Protokoll Arkivit, Njësia Administrative Kolsh, akt nr.648, datë 27.11.2018.
132. \*\*\*\*\*, Specialiste e Ndhmës Ekonomike, Barazisë Gjinore, Njesisë së Mbrojtjes të Fëmijëve dhe PAK, Njësia Administrative Blinisht, akt nr. 406, datë 3.7.2018.
133. \*\*\*\*\*, Specialiste e Bujqësisë dhe A.M.T, Njësia Administrative Blinisht, akt nr.78, datë 28.2.2019.

134. \*\*\*\*\*, Specialist Veterinar, Njësia Administrative Blinisht, akt nr. 79, datë 28.2.2019.
135. \*\*\*\*\*, Specialiste Protokoll-Arkivi, Njësia Administrative Blinisht, Kontratë Pune lidhur në datën 17.9.2018.
136. \*\*\*\*\*, Inspektor i të Ardhurave Vendore, Njësia Administrative Dajç, akt nr. 524, datë 1.11.2016.
137. \*\*\*\*\*, Specialist Jurist dhe I Arsimit dhe Kulturës, Njësia Administrative Dajç, akt nr. 527, datë 21.1.2016.
138. \*\*\*\*\*, Specialist Protokoll Arkivi, Njësia Administrative Dajç, akt nr. 518, datë 1.11.2016.
139. \*\*\*\*\*, Specialiste e Ndhimes Ekonomike PAK dhe Barazisë Gjinore, Njësia Administrative Dajç, akt nr. 526, datë 1.11.2016.
140. \*\*\*\*\*, Specialist i Shërbimeve dhe Kontrollit të Ushqimit, Njësia Administrative Kallmet, akt nr. 378, datë 1.8.2016.
141. \*\*\*\*\*, Inspektor i të Ardhurave Vendore, Njësia Administrative Kallmet, akt nr. 635, datë 27.12.2016.
142. \*\*\*\*\*, Specialiste e Ndhimës Ekonomike, PAK dhe Barazisë Gjinore, Njësia Administrative Kallmet, akt nr. 377, datë 1.8.2016.
143. \*\*\*\*\*, Specialiste e PAK dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, Njësia Administrative Ungrej, akt nr. 323, datë 7.7.2016.
144. \*\*\*\*\*, Specialiste e Ndhimës Ekonomike dhe Barazisë Gjinore, Njësia Administrative Ungrej, akt nr. 324, datë 7.7.2016.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, si në rastin e administratës së bashkisë, ashtu edhe të njësive administrative, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç'ka në vështirësi të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Lezhë, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 113, të po këtij ligji, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Duke u nisur nga rrethanat e evidentuara më sipër, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivelin ekzekutiv, duke pasur në

vëmëndje pikën 8, të nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil, e cila i klasifikon pozicionet e punës në grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit posaçëm.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **V E N D O S A:**

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Lezhë, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **143** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil të evidentuara nominalisht në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse që për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, të cilat në kuptim të ligjit janë vende vakante, të hartohen përshkrimet e punës sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar.
3. Njësia përgjegjësetë shpallë menjëherë për t’u plotësuar pozicionet e shërbimit civil që në kuptim të ligjit janë vende vakante dhe ato të plotësuara në kundërshtim me ligjin dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit, duke realizuar procedurën e rekrutimit në grup për kategorinë ekzekutive.
4. Institucioni tëpërgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
5. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes i cili është finalizuar me vendimin paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, të Komisionerit dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt, sipas urdhërimeve të dispozitivit të këtij vendimi.

6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Lezhë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Lezhë, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Lezhë, Ministria e Brendshme, si dhe çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**